

Njoftim për Shtyp Datë 17 Shtator 2025

Datë: 17.09.2025



Sot, më datë 17.09.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit z. [...], me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016".

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit z. [...], për vitin 2021.

Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidatët:

- Sokol Mara, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 272, datë 14.05.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Klodiana Kryeziu, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 272, datë 14.05.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Eranda Cufo, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 272, datë 14.05.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Genci Busho, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 272, datë 14.05.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 113, datë 27.02.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në vijim, Këshilli vendosi transferimin e gjyqtarit z. Gentian Marku në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në vijim, Këshilli vendosi transferimin e gjyqtarit z. Ardit Kuka në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për:

- 7 (shtatë) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- 1 (një) pozicion i lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në përfundim, pas shprehjes së pëlqimit nga ana e magjistratëve, Këshilli miratoi vendimet për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve:

- Yrfet Shkreli në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Enkel Peza në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Artur Prenga në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Fatmir Ndreu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Gjergji Baçi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Miranda Nakaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Klejda Meçi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Florin Demollari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Njoftime

Njoftime

Dokumentimi i Mbledhjes Plenare

Informacion

Programi i Transparencës

Legjislacioni

Lidhjet

Gjykatat e Republikës së
Shqipërisë